

#20 



Advocacy Center
for **Democratic Culture**



GUSHT
2022

BULETINI



office@acdc-kosovo.org
ngoacdc@gmail.com



Cika Jovina 3, North Mitrovica
Prote Mateje 48, Belgrade
Fehmi Agani 168/5, Prishtina

SOCIAL MEDIA





ANALIZA HULUMTUESE

"RRITJA E BASHKËPUNIMIT NDËRETNIK NË MITROVICËN E VERIUT"

Në kuadër të projektit "Promovimi i dialogut ndëretnik në vetëqeverisjen lokale", i financuar nga National Endowment for Democracy (NED), dhe i zbatuar nga OJQ ACDC, është publikuar analiza e titulluar "Rritja e bashkëpunimit ndëretnik në Mitrovicën e Veriut". Ky hulumtim gjithëpërfshirës kishte për qëllim të hulumtojë pikëpamjet e qytetarëve të të gjitha nacionaliteteve për kushtet e jetesës në këto vendbanime dhe mundësitë për përmirësimin e gjendjes dhe bashkëpunimin e qytetarëve. Përveç kësaj, analiza synon të kontribuojë në rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndëretnik dhe të mbështesë bashkëpunimin dhe iniciativat ndëretnike të cilat do të bashkojnë komunitetet në zonat multi-etnike në Mitrovicën e Veriut.

Analiza e plotë është e disponueshme në faqen e internetit të OJQ ACDC në të tri gjuhët:



www.acdc-kosovo.org

[SRB](#)

[ALB](#)

[ENG](#)

Gjatë muajit gusht vazhduan takimet me përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve. Këto takime do të rezultojnë në nevoja specifike të komunitetit dhe do të mbështesin zhvillimin e ideve të projekteve të vogla. Qëllimi i projektit "Promovimi i dialogut ndëretnik në vetëqeverisjen lokale" është që përmes komitetit për komunitete të punohet në mënyrë efektive me të gjitha komunitetet në Komunën e Mitrovicës së Veriut me qëllim të përcaktimit të nevojave të tyre dhe zhvillimit të projekteve.



Takimet avokuese

Në kuadër të projektit "Gratë për Gratë – të bashkuara në pushtet", në muajin gusht u mbajtën tri takime me gra nga veriu i Kosovës të cilat i'u bashkuan krijimit të një rrjeti të grave që synon fuqizimin e pozitës së grave si dhe promovimin e bashkëpunimit me bashkëpunimet ekzistuese, rrjetet e grave në Kosovë. Si pjesë e të njëjtit projekt, është realizuar edhe një takim avokues me qëllim të përfshirjes më të mirë të grave nga komunitetet joshumicë në procesin e anëtarësimit në BE dhe përfshirjen më të mirë të nevojave dhe prioriteteve të tyre në Raportet e Progresit të Kosovës.



Projekti "Gratë për gratë – të bashkuara në pushtet", zbatohet nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), është mbështetur nga Reactor – Research in Action dhe partnerët e tyre përmes Aksionit "Përparimi i Barazisë Gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE". Ky aktivitet financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim.

Vazhdimi i kontratave me përkthyes dhe bashkëpunëtorët juridik



Më 25 gusht, në prani të kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Ljiljana Stevanović, drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC Dushan Radaković nënshkroi vazhdimin e kontratës me gjashtë përkthyes dhe dy bashkëpunëtorë juridikë në Gjykatën Themelore të Mitrovicës si dhe një bashkëpunëtor ligjor i cili do të angazhohet në departamentin e Gjykatës së Apelit në Mitrovicën e Veriut, për periudhën dhjetë mujore.

Përkthyesit dhe bashkëpunëtorët juridik janë të angazhuar përmes OJQ ACDC në projektin e financuar nga UNMIK-u, "Mbështetja e mëtutjeshme për qasje në drejtësi dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Mitrovicës".



Nga gushti i vitit 2022, OJQ Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, do të vazhdojë të ofrojë shërbime të ndihmës juridike falas në ambientet e saj për të mbështetur Zyrën Mobile të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në veri të Kosovës. Në këtë shënim, OJQ ACDC u bënë thirrje të gjithë atyre që kanë probleme në ushtrimin e të drejtave të tyre në Kosovë që të vizitojnë zyrën tonë dhe të kontaktojnë bashkëpunëtorët juridik të cilët do të ofrojnë shërbime juridike, informacione dhe këshilla falas.


Trajnimi i M4Y



Gjatë muajit gusht, në kuadër të projektit M4Y (Komunat për Rininë), OJQ ACDC zhvilloi sesione trajnimi me vullnetarë dhe monitorues të cilët do të ndihmojnë grupet joformale të të rinjve në zbatimin e projekteve me përgjegjësi sociale. Trajnimet janë realizuar në të katër komunat ku OJQ ACDC zbaton projektin, Zveçan, Vushtrri, Skenderaj dhe Ranillug. Vullnetarët dhe monitoruesit janë gjithashtu të rinj që janë të gatshëm të investojnë kohën dhe njohuritë e tyre për të ndihmuar shoqërinë dhe do të ndihmojnë në zbatimin e 36 projekteve të miratuara në raundin e parë të projektit M4Y në këto katër komuna.

Përveç këtyre aktiviteteve, ekipi i OJQ ACDC filloi fazën e re të zbatimit të projektit M4Y përmes procesit të një fushate informuese dhe mobilizimit të të rinjve për të inkurajuar pjesëmarrjen e të rinjve në trajnimet e M4Y.

Në kuadër të projektit “Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunitetet me shumicë serbe të Kosovës”, financuar nga Byroja Ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe implementuar nga OJQ ACDC në bashkëpunim me OJQ Aktiv, u zhvillua një emision medial, ku në transmetim të ftuarit ishin praktikantë të angazhuar në këtë projekt, Bojana Sërbljak, Milena Mitroviq dhe Velisha Vuçuroviq, të cilët patën rastin të flasin për përvojat e tyre lidhur me punën në institucionet gjyqësore.



@ Srpski Opstanak | Facebook

DISKUTIMI PUBLIK



Diskutimi publik për masat e reciprocitetit të Qeverisë së Kosovës dhe tema të ngjashme është mbajtur në Mitrovicën e Veriut. Pjesëmarrës të këtij debati ishin përfaqësues të organizatave joqeveritare që kanë vite që merren me tema të ngjashme, si dhe media për të diskutuar për zgjidhjet e mundshme. Debati publik u organizua nga Iniciativa Qytetare Serbe për Mbijetesë dhe Iniciativa Qytetare për Zubin Potok. Dushan Radakoviq, drejtor ekzekutiv i OJQ ACDC, mori pjesë në këtë takim si njëri nga panelistët.

Drejtori ekzekutiv i OJQ ACDC, Dushan Radakoviq, ka dhënë një deklaratë për mediumin N1 dhe ka shprehur qëndrimin e tij se si duket në praktikë marrëveshja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, çfarë saktësisht mund të bëhet me ID-në serbe në Kosovë dhe nëse janë institucionet realisht duke u përpjekur për të ruajtur praninë e Serbisë në Kosovë.



NJOFTIM PËR MEDIA

OSHC-të nga komuniteti serb në Kosovë, të organizuara në kuadër të **iniciativës OPEN**, duke përfshirë Qendrën Avokuese për Kulturë Demokratike, lëshuan një komunikatë të përbashkët për media duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të themelojë Komunitetin/Asociacionin e Komunave me shumicë Serbe.

Përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave nga komuniteti serb në Kosovë, anëtarë të platformës Empirika, përfshirë ACDC-në, kanë lëshuar komunikatën për media duke u bërë thirrje të gjitha palëve që në mënyrë paqësore të zgjidhin krizën në veri të Kosovës që u ngrit për shkak të shpalljes së fillimi i zbatimit të vendimit për ri-regjistrimin e targave të Serbisë (me tabela të qyteteve të Kosovës) në RKS dhe vendosjen e reciprocitetit në letërnjoftime të lëshuara nga Republika e Serbisë.



www

SRB

ALB

ENG



www

SRB

ALB

ENG